

Ramadan in Zeiten von Corona

Ramazani në kohën e Koronës

Fletë informacioni për refugjatët myslimanë dhe imigrantët e tjerë në kantonin e Cyrihut përpiluar në bazë të udhëzimeve të Bashkimit e Organizatave Islame në Cyrih VIOZ

Covid-19: Një sëmundje e re, shumë ngjitëse në Zvicër që nga 2020

Ekziston një sëmundje e re virusale. Emri i saj është Covid-19.

Sëmundja e re është e transmetueshme dhe përhapet shumë shpejtë.

Duhet 5 deri në 14 ditë nga infektimi deri në fillimin e sëmundjes (një person që ende duket dhe ndjehet i shëndetshëm mund të jetë tashmë i sëmurë).

Shumë njerëz sëmuren, disa njerëz vdesin. Kjo është arsyeja pse Zvicra është në situatë të jashtëzakonshme. Kjo do të thotë: Ka rregulla të reja dhe më të rrepta.

Këto rregulla vlejnë për të gjithë njerëzit në Zvicër dhe sipas të gjitha gjasave edhe për periudhën e Ramazanit (24 prill – 24 maj 2020).

Udhëzim i përgjithshëm për festimet fetare në Islam

Është pjesë e traditës islame (synite) ndarja e thyerjes së agjërimit (Yftari) me të afërmit dhe miqtë. Është detyrë që të kujdeseni për të tjerët dhe për shëndetin e tyre. Për këtë arsye aktualisht zbatohet:

- Qëndroni në shtëpi nëse është e mundur. Xhamitë mbeten të mbyllura gjatë gjithë muajit të Ramazanit. Ky është një vendim i të gjitha organizatave ombrellë myslimane në Zvicër. Informacione të mëtejshme mund të gjeni në www.vioz.ch.

Shëndeti vjen i pari!

- Ata që ndjehen të sëmurë, çlirohen nga agjërimi. Ditët e lëshuara mund të agjërohen më vonë.
- Ka njerëz për të cilët është veçanërisht e rrezikshme nëse infektohen. Grupi i rrezikut përfshin të gjithë personat mbi 65 vjeç si dhe ata me këto sëmundje:
 - Shtypja e lartë e gjakut
 - Diabeti (sëmundja e sheqerit)
 - Sëmundjet e zemrës dhe të qarkullimit të gjakut
 - Sëmundjet e rrugëve të frymëmarrjes (astma)
 - Sëmundjet dhe terapit që dobësojnë sistemin imunitar
 - Kanceri

Në mungesë të qartësisë për arsye shëndetësore se a duhet të kryhet agjërimi apo jo, një imam ose Këshillimi shpirtëror mysliman në Cyrih (Muslimische Seelsorge Zürich) ofrojnë këshilla.

Iftari

- Thyerja e agjërimit (Iftari) bëhet në familjen tuaj.
- Nuk lejohet të ketë më shumë se 5 vetë së bashku në një takim. Kjo vlen edhe për festimet fetare dhe thyerjën e agjërimit (Iftarit).
- Të gjithë njerëzit duhet të mbajnë distancën e tyre nga njerëzit e tjerë. Më së miri më shumë se 2 metra. Kjo vlen gjithashtu nëse vetëm 2 persona janë së bashku.
- Iftari gjithashtu mund të dërgohet te anëtarët e familjes dhe miqtë. Në këtë mënyrë vlera e iftarit ruhet edhe pa u takuar me njëri-tjetrin.

Lutjet

- Namazet e teravive mund të falen në shtëpi brenda familjes.
- Namazi i Bajramit nuk kryhet në xhami.
- Lutjet e së premtës nuk falen në xhami, por në shtëpi brenda familjes.

Higjiena

- Banja duhet të pastrohet tërësisht pas larjeve rituale (abdesit).
- Mos përqafoni askënd.
- Mos i shtrëngoni duart.
- Lani duart shpesh.

Nëse keni ndonjë pyetje, ju lutemi drejtohuni në

VIOZ (info@vioz.ch)

Këshillimi shpirtëror mysliman në Cyrih (043 205 21 29).